



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
Sesioni pranveror

**Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi**

Mbledhja nr. 50  
Prishtinë, më 15.1.2019, në orën 13:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Mufera Shinik, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Driton Çausi, Arbërie Nagavci dhe Albulena Balaj-Halimaj.

**Munguan:** Fidan Rekalju, Abdyl Salihu, Verica Çeraniç dhe Nezir Çoçaj.

**Të ftuar:** Shyqiri Bytyqi, ministër i MASHT-it dhe Rrahman Jasharaj, kryetar i SBASHK- ut.

**Përfaqësues tjerë:** përfaqësues të KDI- së dhe mediave.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

**Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i komisionit.**

Për këtë mbledhje u propozua ky

**Rend i ditës:**

**1. Diskutim lidhur me grevën e mësimdhënësve**

Ismajl Kurteshi, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen me të vetmen pikë të rendit të ditës duke pasur parasysh grevën e mësimdhënësve dhe krijimin e mundësisë për të dalë nga kjo situatë. Ai tha se mundësia e arritjes së një kompromisi nga MASHT-i dhe SBASHK-u me qëllim të arritjes së një marrëveshjeje mirëkuptimi, për daljen e mësimdhënësve nga greva në mënyrë që mos të dëmtohet sistemi arsimor për shkak se për afërsisht një e katërta e popullatës duke nisur prej çerdheve e deri në universitete është duke pësuar nga kjo grevë.

Ai tha se ne, si komision, do të japim kontributin tonë që greva që ka filluar dje të ndërpritet, sepse greva nuk është e dëshirueshme, janë deklaruar edhe vetë iniciatorët e grevës. Jemi këtu bashkë t' i shprehim mendimet tona dhe në fund do të kërkojmë nga dy palët nga qeveria dhe nga SBASHK-u që sa më parë të arrihet një marrëveshje. Kjo mund të arrihet vetëm kur palët kanë mirëkuptim dhe zgjidhjen e kërkojnë brenda mundësive reale.

Shyqiri Bytyqi, theksoi se MASHT-i e ka ngritur shqetësimin lidhur me çështjen e renditjes së koeficientit të mësimdhënësve. Ai tha se vazhdimisht kanë qenë në kontakt me SBASHK-un, duke diskutuar për mundësitë e gjetjes së një zgjidhjeje sa më të mirë për sistemin arsimor. Po ashtu tha se nga SBASHK-u kanë kërkuar që të jenë në bashkërenditje të veprimeve me MASHT-in, në mënyrë që të mos dëmtohet sistemi arsimor. Ai tha se MASHT-i ka propozuar një ngritje të koeficientit, duke i rritur pagat për mësimdhënësit, në koordinim mes Qeverisë së Kosovës dhe MASHT-it, presim nga SBASHK-u që të reflektojë duke e ndërprerë grevën. Sot ka qenë ky propozim i qeverisë dhe presim reflektimin nga ana e SBASHK-ut. Mendoj që tashmë Qeveria e ka këtë ofertë dhe SBASHK-u duhet ta shqyrtojë atë.

Rrahman Jasharaj, kryetar i SBASHK-ut, tha se pas shumë kërkesave të tyre për ngritje të koeficientit për mësimdhënësit, nuk kanë gjetur zgjidhje tjetër përveçse përmes grevës. Nuk kemi lënë derë pa trokitur, duke alarmuar se vërtet versioni aktual është diskriminues. Qeveria e Kosovës, më 3 shtator, solli një shtetë të keq për punëtorët e arsimit. Qeveria votoi një ligj diskriminues. Vetë fakti se po pranohet se me versionin aktual po shkatërrohet sistemi arsimor, flet mjaft. Më 28 dhjetor e mbajtëm një grevë për ta dhënë alarmin e fundit dhe nuk ndodhi asgjë. Ne nuk kishim kah t'ia mbajmë më. Ai shtoi se në sektorët tjerë koeficienti ngrihet deri në 100 %, ndërkaq kërkesa e mësimdhënësve prej ngritje prej 30% nuk realizohet.

Ymer Ymeri, SBASHK, tha se psikologu i shkollës paguhet më pak se psikologu i një qendre klinike. Nuk po kërkojmë rritje pagash, por për punën e njëjtë të paguhemi barabartë.

Teuta Haxhiu tha se greva e mësimdhënësve e filluar pas pushimit dimëror nuk është instrument i duhur, personalisht nuk pajtohet me koeficientin e paraparë për mësimdhënës sipas projektligjit për pagat. Më tej tha se pas shumë viteve insistim për projektligjin për mësimdhënësit e viteve të 90-ta, pikërisht kjo qeverie ka sjellë në Kuvend dhe gjatë kohës së shqyrtimit të tij kemi pasur një bashkëpunim të përditshëm me SBASHK-un. Lidhur me këtë kërkoi sqarim nga ministri lidhur me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të ministrisë në dëgjimet publike dhe diskutimet gjatë hartimit të projektligjit për pagat nga MAP. Me këtë rast sqaron se në këtë fazë adresimi i kërkesave nga ana e SBASHK-ut është Kuvendi, e jo Qeveria. Andaj lidhur me këtë propozoi që komisioni t'i nxjerrë dy rekomandime, një rekomandim që i adresohet Komisionit për Administratë Publike lidhur me ngritjen e koeficientit për mësimdhënësit dhe rekomandimi i dytë për ka të bëjë që në seancën e parë të Kuvendit të Kosovës të futet me urgjencë shqyrtimi i projektligjit për mësimdhënësit e viteve të 90-ta.

Valentina Bunjaku-Rexhepi, në diskutimin e saj, tha se takimi i komisionit me përfaqësues të MASHT-it dhe SBASHK-ut është i domosdoshëm. Ajo tha se nuk e përkrah grevën e mësimdhënësve për shkak se humbja e mësimi nuk mund të kompensohet në asnjë mënyrë, ndërsa kërkesat e SBASHK-ut që kanë të bëjnë ngritjen e koeficientit të mësimdhënësve dhe

rangimin e tyre i konsideron legjitime. Ajo tha se do ta jep kontributin e saj për ngritjen e koeficientit dhe trajtimin meritore të mësimdhënësve në ligjin për pagat.

Arbërie Nagavci tha se secili prej nesh nuk e përkrah grevën dhe mendojmë se nuk është rruga e duhur, por kjo ka ardhur si rezultat i një qeverie të papërgjegjshme e cila ia rrit pagat vetes, falë dhjetëra miliona euro në mënyrë të jashtëligjshme dhe pa asnjë kriter, një qeveri që stërmbyshur me ministra, zëvendësministra e këshilltarë sigurisht që do të nxisë reagime të shumë sektorëve të tjerë. Sa i përket projektligjit të pagave tha se është shumë i dobët, ka dallime të mëdha në sektor të ndryshëm, ky projektligj favorizon presidentin, deputetët e qeverinë ndërsa është në disfavor të disa kategorive, veçanërisht të mësimdhënësve. Lidhur me këtë tha se ka paraqitur 14 amendamente për ta ndryshuar projektligjin për pagat dhe shumica prej tyre kanë të bëjnë me sektorin e arsimit. Ajo ceku se projektligji për pagat ka një kosto prej 90 milionë euro, e cila kosto nuk është paraparë në ndarjet buxhetore për vitin 2019. Në vazhdim ngriti çështjen e cilësisë së dobët në arsim në të gjitha nivelet, për të cilën tha se është përgjegjësi e të gjitha qeverive gjatë gjithë këtyre viteve që kanë ndërhyrë në të gjitha nivelet. Më tej shtoi se mësimdhënësit duhet të pagohen për punën e tyre, të trajtohen me dinjitet dhe të kërkohej përgjegjësi dhe llogaridhënie nga ana e tyre. Në vazhdim kërkoi sqarim nga SBASHK- u lidhur me përfundimin e grevës duke pasur parasysh se kërkesat e tyre marrin kohë, ndërsa humbja e mësimi është e madhe dhe nuk mund të kompensohet.

Driton Çausi, në diskutimin e tij, tha se pajtohet me shqetësimet e SBASHK-ut për sa i përket trajtimit jo të barabartë përmes projektligjit për paga për shkak se përmes tij shpërfaqet një pabarazi e madhe se si trajtohen punëtorët në sektor të ndryshëm. Pajtohemi të gjithë që greva ka qenë mjeti i fundit, por të gjithë duhet shikuar mundësinë për të kontribuar për zgjidhjen e kësaj situatë për hir të asaj që u diskutua më herët. Ka qenë insistimi ynë në mbledhjen e fundit që të mos kalojë Ligji i buxhetit për vitin 2019 pa një trajtim serioz për atë që meritojnë punëtorët e arsimit dhe ata të shëndetësisë. Ai shtoi se kur zgjedhim mjetet më radikale për realizimin e kërkesave siç është greva, duhet pasur parasysh që të jemi shumë serioz në mënyrën se si i parashtrijmë kërkesat, andaj lidhur me këtë shtoi se nuk e ka të qartë se si mund të jetë kërkesa për rritje 30 % të pagave për sistemin arsimor në të gjitha nivelet duke filluar nga çerdhet deri të arsimit universitar.

Muferra Sinik, në diskutimin e saj, tha se presim nga MASHT dhe SBASHK- u që të arrijnë një marrëveshje për ndërprerjen e grevës, personalisht nuk pajtohet me koeficientin e paraparë për mësimdhënësit në projektligjin për paga, mirëpo shpreson që kjo të përmirësohet në fazën e amendamentimit të projektligjit në Kuvend. Si përfaqësuese e grupit parlamentar 6+ kërkoi nga SBASHK- u që të merr vendim për ndërprerjen e grevës dhe të vazhdohej me punën në Kuvend në shqyrtimin dhe amendamentimin e projektligjit për paga.

Albulena Balaj-Halimaj tha se nga diskutimet e gjertanishme shihet qartë se të gjithë jemi kundër koeficientit për mësimdhënësit të paraparë në projektligjin për paga, e po ashtu të gjithë jemi të pajtimit që të kemi një koeficient më të mirë për mësimdhënësit. Ajo tha se greva e filluar është e panevojshme dhe jo në kohën e duhur për shkak se projektligji për paga është në fazën e shqyrtimit dhe amendamentimit në komisionin përkatës, në të cilin komision janë të përfaqësuar të gjitha grupet parlamentare dhe aty mund të bëhet ndryshimi i koeficientit. Më tej shtoi se vetë

fakti se ministri i MASHT-it nuk e ka përkrahur këtë koeficient dhe ka paraqitur vërejtjet e tij, nuk është dashur të mbahet greva.

Shyqiri Bytyqi tha se këto takime duhet të kontribuojnë për të dalë nga kjo situatë e krijuar dhe të kthehet normaliteti në sistemin arsimor, pajtohet me diskutimin e deputetit Driton Çausi lidhur me atë se kërkesa e SBASHK- ut për rritje 30 % të pagave për të gjithë sistemin arsimor nuk është e drejtë. Lidhur me çështjen e ngritur nga deputetja Teuta Haxhiu lidhur me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të MASHT në dëgjimet publike dhe diskutimet gjatë hartimit të projektligjit për pagat në MAP, tha se MASHT gjatë fazës së hartimit të projektligjit për pagat ka marrë pjesë në të gjitha diskutimet dhe ka paraqitur vërejtjet dhe propozimet e veta për secilin pozicion, të cilat vërejtje nuk janë marrë parasysh, sikurse që ka kundërshtuar këtë projektligj edhe në mbledhjen e qeverisë.

Rrahman Jasharaj, në përmbyllje të takimit, tha se mësimdhënësit e Kosovës nuk janë duke kërkuar lëmshë as nga Qeveria as nga MASHT-i, por po kërkojnë ngritjen e koeficientit dhe një trajtim meritor.

Ismajl Kurteshi tha se në këtë takim u paraqiten pikëpamje të ndryshme nga përfaqësues të MASHT-it dhe SBASHK-ut, kërkoi që të arrihet një marrëveshje sa më parë pasi që kjo situatë tejkalohet vetëm me një marrëveshje mes palëve. Greva nuk i shërben askujt, sepse nga kjo pësojnë jo vetëm nxënësit, por i gjithë sistemi arsimor. Tha sa është i papranueshëm koeficienti aktual për mësimdhënësit i përcaktuar në projektligjin për paga dhe kërkoi nga SBASHK- u që të takohet me Këshillin Drejtues dhe të marrë vendim për ndërprerjen e grevës.

Mbledhja përfundoi në orën 14:45.

***E përgatiti:***

***Stafi mbështetës i komisionit.***

**Kryetari i komisionit,**

-----

**Ismajl Kurteshi**